

## Të shprehurit

Nëse keni ndonjë shqetësim apo dyshim se ka ndodhur një shkelje e ligjit, e kodit tonë të sjelljes apo e kodit të furnizuesit, atëherë dëshirojmë që të shpreheni.

Ne synojmë të nxisim sinqeritetin dhe do t'i mbështesim personat që ngrenë shqetësime, edhe nëse rezulton se e kanë gabim. Megjithatë, një shqetësim i ngritur me keqdashje mund të çojë në marrjen e masave disiplinore.

Kodi ynë i sjelljes dhe kodi i furnizuesit janë të disponueshëm në intranet dhe në: [www.imperialbrandspc.com](http://www.imperialbrandspc.com). Pyetjet mund t'i dërgoni me email në [Governance.Team@impbrands.com](mailto:Governance.Team@impbrands.com)

## Ka disa mënyra se si mund të shpreheni:

### 1. Shprehuni në nivel vendor

Nëse është komode për ju, duhet t'ia paraqitni shqetësimet menaxherit tuaj të stafit ose ekipit vendor përgjegjës për burimet njerëzore.

### 2. Shprehuni në nivel Grupi

Nëse nuk jeni komod t'ia ngrini shqetësimet një kolegu, ose nëse i keni ngritur ato në nivelin vendor dhe besoni se nuk keni marrë përgjigje të mjaftueshme prej tij, ju inkurajojmë të dërgoni një raport përmes sistemit tonë të automatizuar të raportimit konfidencial. Ky është një sistem i sigurt, i lehtë për t'u aksesuar dhe për t'u përdorur, i cili do të garantojë që raporti juaj të përcillet shpejtë te personat e duhur. Nëse preferoni, raportin mund ta dorëzoni në mënyrë anonime.

Sistemin mund ta aksesoni nga kompjuteri juaj ose nga një pajisje celulare, duke vizituar <https://imperialbrands.whistleblowernetwork.net>. Ose mund të skanoni kodin QR të mëposhtëm me anë të kamerës së pajisjes suaj:



Sapo të hyni në sistem, mund të dërgoni një raport me shkrim ose të regjistroni një mesazh zanor (aktualisht nuk mbështetet në iOS) dhe, nëse dëshironi, mund të bashkëngjitni gjithashtu dokumente, fotografi ose video që mbështesin raportin tuaj. Nëse zgjidhni të lini një mesazh zanor, zëri juaj do të maskohet në mënyrë dixhitale për të mbrojtur identitetin tuaj në rast se preferoni të mbeten anonimë.

Nëse preferoni, në shtete të caktuara mund të telefononi gjithashtu në një linjë vendore falas dhe të ndiqni udhëzimet e automatizuara për të lënë mesazhin tuaj. Një listë të shteteve dhe të numrave e gjeni [këtu](#). Thjesht futni kodin 25492 kur t'ju kërkohet.

Pavarësisht opsionit që zgjidhni, do të ftoheni të krijoni një kuti të sigurt postare, e cila na siguron një mënyrë të sigurt dhe efektive për të komunikuar me ju përmes sistemit dhe për t'ju ofruar komente.

## Garancia jonë për ju

Në masën që është e mundur, ne do të ruajmë anonimitetin dhe konfidencialitetin e shqetësimeve tuaja. Megjithatë, për të kryer një hetim të saktë, mund të nevojitet që disa informacione të zbulohen.



Ju mund të zgjidhni ta ngrini shqetësimin në mënyrë anonime, me kusht që kjo të lejohet nga ligjet e shtetit në të cilin punoni.

Ne nuk tolerojmë shpajim ndaj një individi që shprehet apo ndihmon në një hetim.

Nëntor 2020